



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**Njoftim lidhur me procesin zgjedhor për Zgjedhjet e Përgjithshme për
Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 09.02.2025.**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), gjatë procesit zgjedhor për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 09.02.2025, bazuar në Ligjin Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nga i cili buron juridiksioni për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka pranuar 642 ankesa të parashtruara nga palët me interes ligjore.

PZAP-i, për të gjitha ankesat e pranuar, ka arritur ti shqyrtoj dhe të vendosë brenda afateve të përcaktuar në Ligjin Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, sipas kësaj mënyre të vendimmarrjes;

- Aprovim - 249 vendime,
- Refuzim - 242 vendime,
- Të palejuara - 73 vendime,
- Të tërhequra - 4 vendime,
- Të pas afatshme - 53 vendime,
- Të dorëzuara në Komisionin e Pavarur për Media - 17 ankesa,
- Të dorëzuara në Këshillin e Mediave të Shkruara - 2 ankesa,
- Pjesërisht të pranuar - 2 vendime.

Në kuadër të vendimeve të nxjerra, PZAP-i për Subjektet Politike që kishin shkelur Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatet, ka shqiptuar gjoba në vlerë prej **644,100.00 euro**, prej të cilave deri me tani janë paguar vetëm **101,000.00 euro**.

Ndaj vendimeve të PZAP-it, janë paraqitur 47 ankesa në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, ndër to; në 34 raste vërtetohen vendimet e PZAP-ës, ndryshohen pjesërisht 7 vendime, ndërsa 6 vendime të PZAP-ës ndryshohen nga Gjykata Supreme.

Me certifikimin e rezultateve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 09.02.2025, ku konsiderohet edhe përmbyllja e procesit zgjedhor, PZAP-ja falënderon të gjithë akteret zgjedhor, që në një mënyra ose tjetër kanë qenë të përfshirë në proces, parashtruesit e ankesave, mediat për komunikimin e vazhdueshëm dhe pasqyrimin e drejt për punën e zhvilluar në PZAP, shoqërinë civile, publikun e gjerë, dhe përfaqësuesit e misionit vëzhgues të Bashkimit Evropian, të cilët për një kohë të caktuar kanë ndjekur nga afër punën e PZAP-it, dhe se kanë paraqitur në mënyrë objektive në raportin e tyre, profesionalizimin e vendimmarrjes së anëtareve të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia.

Njeherit, për të gjitha ata që dëshirojnë të kenë më shumë informata në lidhje me procesin zgjedhor për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 09.02.2025, deri në përgatitjen e raportit përfundimtarë, mund t'i qasen web faqes së PZAP-ës, në të cilën janë pasqyruar të dhënat për parashtruesit e ankesave, natyrën e ankesës dhe vendimet e publikuara të PZAP-së.